



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### VENDIM

Nr. 05, dt. 30.06.2021

#### **MBI DISA NDRYSHIME PROGRAMIN E INVESTIMEVE PER VITIN 2021**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit "Për buxhetin e vitit 2021", Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2021, Vendimin e Keshillit të Qarkut nr. 09 date 18.12.2020 "Mbi miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut per vitin 2021", Vendimin e Keshillit të Qarkut nr. 02 date 17.03.2021 "Mbi disa ndryshime ne buxhetin e Keshillit të Qarkut per vitin 2021 dhe miratimin e perdorimit te te ardhurave te trasheguara nga viti 2020", me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

### V E N D O S I

1. Të miratojë rialokimin e fondeve te investimeve te paperdoruara nga procedura e prokurimit ne 12.4 milion leke.
2. Të miratojë shtesë në Programin e Investimeve te Keshillit te Qarkut per objekte si me poshte:
  - "Rehabilitimi i rruges te fshatit Cete, Bashkia Devoll me vlere 7.7 milion leke
  - Fond per mbikqyrje punime dhe kolaudim per objektin "Rehabilitimi i rruges te fshatit Cete, Bashkia Devoll me vlere 200 mije leke
  - "Blerje automjet per nevoja te punes te Keshillit te Qarkut" me vlere 4.5 milion leke
3. Te miratoje ndryshime ne zerin Investime sipas Strukturave buxhetore si me poshte:  
Pakesim fondi  

Gr. 00	Tit. 04520	Kap. 01	Art. 231	2500000 leke
Gr. 00	Tit. 09120	Kap. 05	Art. 231	2000000 leke

  
Shtese fondi  

Gr. 00	Tit. 01110	Kap. 01	Art. 231	2500000 leke
Gr. 00	Tit. 01110	Kap. 05	Art. 231	2000000 leke
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit, të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut, Dega e Thesarit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ana VERUSHI

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Konceptoi L.Pleqi  
Juristi Gj. Kristo  
Sek.K.qarkut B. Muço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### RELACION

#### ***MBI DISA NDRYSHIME NE PROGRAMIN E INVESTIMEVE PER VITIN 2021***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2021”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2021, Vendimin e Keshillit të Qarkut nr. 09 date 18.12.2020 “Mbi miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut për vitin 2021”, Vendimin e Keshillit të Qarkut nr. 02 date 17.03.2021 “Mbi disa ndryshime në buxhetin e Keshillit të Qarkut për vitin 2021 dhe miratimin e përdorimit të të ardhurave të trashëguara nga viti 2020”, Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit ka ndjekur realizimin e procedurave të tenderimit për objektet e miratuara në Programin e Investimeve për vitin 2021.

Në përfundim të periudhës 6/mujore dhe përfundimit të disa procedurave të tenderimit rezultoi një fond i përdorur prej 12.4 milion leke. Në këto kushte në propozojmë rialokimin e kësaj fondi për financimin e dy objekteve të rëndësishme.

Në vijim të Programit tonë për financimin e objekteve në infrastrukturë me përfitues bashkitë e qarkut, filluar që në vitin 2018, Bashkia Devoll ka ardhur me një propozim për nderhyrje në një rrugë në fshatin Çetë, e cila do të përmirësojë infrastrukturën në këtë zonë.

Gjithashtu që në hartimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut për vitin 2021 u trajtua problemi i blerjes së një automjeti për nevojat e punës të administratës së Keshillit të Qarkut dhe Drejtorisë të AMT në qark. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e amortizimit të ndjeshëm të mjetit ekzistues si dhe një mjeti tjetër tejet të amortizuar. Por meqë në atë periudhë ishin primare planifikimi i fondeve në disa objekte sipas propozimeve të bashkive, grupi i punës për hartimin e buxhetit gjykoi që investimi për blerje automjeti të lihej një kohë të dytë.

Në kushtet e rialokimit të fondeve për investime me 12.4 milion leke, propozojmë për miratim objektet si më poshtë:

1. “Rehabilitimi i rrugës të fshatit Çetë, Bashkia Devoll me vlerë 7.7 milion leke
2. Fond për mbikqyrje punime dhe kolaudim për objektin “Rehabilitimi i rrugës të fshatit Çetë, Bashkia Devoll me vlerë 200 mijë leke
3. “Blerje automjeti për nevojat e punës të Keshillit të Qarkut” me vlerë 4.5 milion leke

Gjithashtu propozojmë disa ndryshime në zerin Investime sipas Strukturave buxhetore për realizimin e objekteve të mësipërme.

Pakesim fondi

Gr. 00	Tit. 04520	Kap. 01	Art. 231	2500000 leke
Gr. 00	Tit. 09120	Kap. 05	Art. 231	2000000 leke
Shtese fondi				
Gr. 00	Tit. 01110	Kap. 01	Art. 231	2500000 leke
Gr. 00	Tit. 01110	Kap. 05	Art. 231	2000000 leke

Thëksojmë se të gjitha ndryshimet do të jenë brenda zerit të investimeve të miratuara për vitin 2021.

Korce, më 21.06.2021

Drejtoresha e Financës  
Liljana Pleqi